

VENDIM
Nr. 355, datë 1.12.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2416/1 prot., datë 24.11.2023 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2416 prot., datë 17.11.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Të depozitohet vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti) e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “a”: Të raportohet mbi vlerën e debisë së pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër, si dhe shlyerjen e kështit të fundit që i përket datës 20.12.2023, sipas planit të pagesave të “Marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve tatimore”, me nr. 1943/1 prot., datë 30.6.2022, nënshkruar midis Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër dhe shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., duke mbajtur në konsideratë se duhet të depozitohet në ERE vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera, si ndaj organeve tatimore, ashtu edhe ndaj atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa “b”: Të depozitohet dokumentacion mbi mbështetjen financiare, e cila duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi.

- Germa “c”: Të depozitohet në ERE plani i biznesit i dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 2.5, “Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike”

- Shoqëria duhet të saktësojë të dhënat në lidhje me sasinë e energjisë elektrike (në gwh) që parashikon të tregtojë gjatë 5 (pesë) vjetëve të ardhshëm të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti